



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E TURIZMIT, PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT, MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

RELACION

**PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR PËRMIRËSIMIN E DEKORIT TË QYTETIT,
SHTIMIN E AKTIVITETEVE NË FESTAT E FUNDVITIT ME QËLLIM RRITJEN E NUMRIT
TË VIZITORËVE ME IMPAKT NË EKONOMINË LOKALE**

Korça mbetet destinacioni kryesor i shqiptarëve dhe vizitorëve të huaj, të cilët e përzgjedhin këtë qytet për të festuar festat e fundvitit. Dekori i veçantë me të cilën është zbukuruar qyteti, gjatë muajit dhjetor si dhe aktivitetet e shumta të organizuara gjatë gjithë vitit tërheqin tursitë të shumta vendas dhe të huaj.

Muaji Dhjetor është me i frekuentuari, çka do të thotë se mbi 80% e hoteleve dhe bujtinave që operojnë në qytet janë rezervuar muaj më parë, duke e bërë Korçën destinacionin turistik më të frekuentuar gjithëvjetor.

Me qëllim reklamimin dhe promovimin e Korçës në të gjithë vendin dhe tërheqjen e sa më shumë vizitorëve me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik vendor përmes zhvillimit të turizmit, Bashkia Korçë ka menduar të bëjë realizojë një dekor të veçantë si dhe të shtojë numrin e aktiviteteve që do të realizohen gjatë muajit dhjetor si më poshtë:

- Shtëpiza druri (5 copë x 360,000 lekë) = 1,800,000 lekë
- Mirëmbajtja e pistës së patinazhit+ blerje e 60 palë patina 700,000 lekë
- Materiale ndihmëse për dekor 700,000 lekë
- Shirita dekorues me drita 7,100,000 lekë

Të gjitha shpenzimet e mësipërme në vlerën 10,300,000 lekë do të menaxhohen dhe do të shtohen buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Gjithashtu, në buxhetin e Qendrës së Artit dhe Kulturës do të shtohet fondi prej 1,200,000 lekë në zërin “Marrje me qera skenë, foni, ndriçim” për festat e fundvitit. Këto shpenzime do të përballohen nga fondi i planifikuar në zërin “Rikonstruksioni i bibliotekës së fëmijëve Thoma Turtulli”, në programin AG 122, Arsimi bazë parashkollor , me kod produkti P912AAB si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET	AG122 00	Art. 2310000 01	Prod P912AAB	-5,000,000 lekë (Bashkia)
PAKËSOHET	AG122 00	Art. 2310000 05	Prod P912AAB	-6,500,000 lekë “”
SHTOHET	AE122 00	Art. 2310000 05	Prod.V626AAH	+ 1,800,000 lekë (Nd. Shërb. Publike)

SHTOHET	AE122 00	Art. 6020000 05	Prod.V626AAH	+ 700,000 lekë (Nd. Shërb. Publike)
SHTOHET	AE122 00	Art. 6020000 05	Prod.V644AAA	+ 7,800,000 lekë “”
SHTOHET	AF122 00	Art. 6020000 05	Prod.V822AAA	+ 1,200,000 lekë (Qendra e Artit dhe Kulturës)

Duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë”, si dhe urdhrin nr. 14 datë 10.1.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2023 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve, i ndryshuar, kërkojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak riallokimi i fondeve për përmirësimin e dekorit të qytetit, shtimin e aktiviteteve në festat e fundvitit me qëllim rritjen e numrit të vizitorëve me impakt në ekonominë lokale.

DREJTORIA E TURIZMIT, PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT,

MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Alba VELUSHI

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS

BUXHETIT MENAXHIMIT

FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME

JURIDIKE DHE MENAXHIMIT

TË BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ date _____ .2023

PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR PËRMIRËSIMIN E DEKORIT TË QYTETIT, SHTIMIN E AKTIVITETEVE NË FESTAT E FUNDVITIT ME QËLLIM RITJEN E NUMRIT TË VIZITORËVE ME IMPAKT NË EKONOMINË LOKALE

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit, Migracionit dhe Diasporës, si dhe bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjin nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë” si dhe urdhrin nr. 14 datë 10.1.2023 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2023 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe produkteve mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rialokimin e fondeve për përmirësimin e dekorit të qytetit, shtimin e aktiviteteve në festat e fundvitit me qëllim rritjen e numrit të vizitorëve me impakt në ekonominë lokale për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike dhe Qendrën e Artit dhe Kulturës si më poshtë.

- Shtëpiza druri (5 copë x 360,000 lekë) = 1,800,000 lekë
- Mirëmbajtja e pistës së patinazhit+ blerje e 60 palë patina 700,000 lekë
- Materiale ndihmëse për dekor 700,000 lekë
- Shirita dekorues me drita 7,100,000 lekë
- “Marrje me qera skenë, foni, ndriçim për festat e fundvitit” 1,200,000 lekë

2. Fondet do të përballohen nga fondi i planifikuar në zërin “Rikonstruksioni i bibliotekës së fëmijëve Thoma Turtulli”, në programin AG 122, Arsimi bazë parashkollor , me kod produkti P912AAB dhe me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET	AG122 00	Art. 2310000 01	Prod P912AAB	-5,000,000 lekë (Bashkia)
PAKËSOHET	AG122 00	Art. 2310000 05	Prod P912AAB	-6,500,000 lekë “”

SHTOHET	AE122 00	Art. 2310000 05	Prod.V626AAH	+	1,800,000 lekë (Nd. Shërb. Publike)
SHTOHET	AE122 00	Art. 6020000 05	Prod.V626AAH	+	700,000 lekë (Nd. Shërb. Publike)
SHTOHET	AE122 00	Art. 6020000 05	Prod.V644AAA	+	7,800,000 lekë “”
SHTOHET	AF122 00	Art. 6020000 05	Prod.V822AAA	+	1,200,000 lekë (Qendra e Artit dhe Kulturës)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit, Migracionit dhe Diasporës, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Qendra e Artit dhe Kulturës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike .

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

Ana VERUSHI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____